

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË VLORE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Vlorë**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, funksionimi i policisë bashkiake, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, etj.”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 30.6.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 707/13, datë 30.6.2014, i ka rekomanduar z. Shpëtim Gjika, Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PËR PËRMIRËSIM LIGJOR:

Nga auditimet e kryera nga KLSH gjatë vitit 2013, në Njësitë e Qeverisjes Vendore, rezulton se në mjaft prej tyre qytetarët nuk paguajnë taksat dhe tarifat vendore, për arsyen e mungesës së strukturave dhe pamundësinë praktike të mbledhjes së tyre për çdo familje. Vetëm në Bashkinë e Tiranës banorët paguajnë taksën e pastrimit në Ujësjellës Sh.a, bashkë me faturën e ujit, ndërsa Bashkia Vlorë nuk ka arritur të grumbullojë taksat vendore nga banorët. Kështu nga auditimet e kryera në Bashkitë Fier dhe Vlorë ka rezultuar se nuk mbledhet as 10% e vlerës së taksave të llogaritura, duke sjellë si pasojë mosarkëtimin e shumave të konsiderueshme në buxhetet e tyre nga vlera që variojnë rreth 60-70 milion lekë në vit. Ky problem rezulton të ketë gjetur zgjidhje në Bashkinë e Korçës, ku nga bashkia dhe Ujësjellës Sh.a. është lidhur një marrëveshje duke caktuar si agjent tatimor ndërmarrja, dhe aktualisht rezultatet kanë treguar një nivel arkëtimi shumë të lartë të taksave e tarifave vendore.

Sipas VKM nr. 660, datë 12.09.2007 *“Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjellësave dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes vendore”*, një pjesë e aksioneve të Ujësjellësave sha u ka kaluar Bashkive, ku edhe Këshillat Mbikëqyrëse caktohen nga Këshillat Bashkiake.

Nisur sa sipër, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, neni 5, -Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas shkronjës ii) -përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella; nenin 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”* i ndryshuar, pikës 7.1, të UMF, nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për Procedurat Tatimore”* i ndryshuar, nenin 26 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 *“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”*, **ti kërkojmë** Ministrin të Shtetit për Çështjet Vendore, Ministrinë Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministrinë Transporteve dhe Infrastrukturës, Ministrinë Energjetikës dhe Ministrin Financave, që të nxjerrin një akt nënligjor ose të hartojnë marrëveshje Tip me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve, duke orientuar ose caktuar si agjent tatimor Ndërmarrjet e Ujësjellësit, sha, në rrethe, ose dhe “ÇEZ” sha e degët e tyre në rrethe, që në faturën e ujit të pijshëm dhe energjisë eklektike, të arkëtohen edhe taksat e popullatës, (taksa e banesave, pastrimit, gjelbërimit, etj), **duke bërë dhe përmirësimet e duhura në legjislacionin në fuqi.**

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pazbatuara të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të dërguara me shkresën nr. 83/7, prot, datë 27.07.2011 për shfuqizimin e 6 Lejeve të KRRT-së, dhe shpërblim dëmi nga 4 subjekte për vlerën e dëmit ekonomik **prej 2,346,060 lekë**.

Deri me datë 30 Korrik 2014

2. Të merren masa për implementimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*". Për këtë:

-Të rishikohet struktura organizative, me synim reduktimin e numrit të punonjësve në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

-Të miratohet strategjia e riskut dhe të hapet regjistri i tij, ku të evidentohen parregullsitë dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit.

-Të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27/12/2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

Deri me datë 30 Korrik 2014

3. Titullari i njësisë publike (Kryetari i Bashkisë), të marrë masa që të zbatojë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, duke synuar vendosjen e sistemit të kontrollit të brendshëm, informacioni dhe komunikimi si dhe monitorimi, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10926, datë 08.7.2010.

Vazhdimisht

4. Sektori i Auditimit të Brendshëm në hartimin e programeve të auditimit për shkeljet e konstatuara gjatë auditimeve, të vendosë të plotë bazën ligjore përkatëse, ndërsa rekomandimet dhe masat e kërkuara për shkeljet e konstatuar gjatë auditimeve të jenë konkrete dhe të mbështetura mbi kriteret ligjore për çdo gjetje.

Vazhdimisht

5. Plotësimi i formularëve standard dhe kryerja e testimeve për sistemet e audituara të bëhet në zbatim të kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm (MAB) të miratuar me UMF nr. 69, datë 29.9.2010 dhe nr. 12, datë 5.6.2012 "*Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik*".

Vazhdimisht

6. Punonjësja e Auditit të Brendshëm e cila në momentin e auditimit nuk kishte dëshminë përkatëse, të pajiset me Çertifikatën e dëshmisë "*Auditues i brendshëm në sektorin publik*", në të kundërtën të transferohet nga sektori i Auditit të Brendshëm në sektorë të tjerë. Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16/09/2010, pika 3, neni 19.

Deri më datën 31.12.2014

7. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë, të kryhet evidentimi duke listuar elektronikisht abonentët familjarë për të cilët nuk janë aplikuar detyrimi për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit për periudhën 2010 – 2013 , si

dhe hartojë njoftim vlerësimet në zbatim të pika 3, nenit 70, “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “*Për Procedurat Tatimore*”.

Të merren masa, të kryhen rillogaritjet përkatëse dhe të arkëtohen detyrimet nga familjarët në shumën totale **129,878 mijë lekë** që sipas viteve paraqitet:

-Për vitin 2011 në shumën 45,153 mijë lekë.

-Për vitin 2012 në shumën 47,166 mijë lekë.

-Për vitin 2013 në shumën 37,559 mijë lekë.

Deri me datë 30 Shtator 2014

8. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë të merren masa për rillogaritjen e detyrimeve të prapambetura nga subjektet e biznesit të vogël, klasifikuara sipas llojit dhe vlerës të detyrimit dhe të kërkojë arkëtimin e detyrimeve përkatëse. Procedurat ligjore të bëhen në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar, pikat 130-132 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për Procedurat Tatimore*”, i ndryshuar për vlerën **210,231 mijë lekë**, respektivisht:

-Për vitin 2011 paraqiten 1,074 debitorë në shumën **50,260** mijë lekë.

-Për vitin 2012 paraqiten 1,466 debitorë në shumën **73,787** mijë lekë.

-Për vitin 2013 paraqiten 1,890 debitorë në shumën **86,184** mijë lekë.

Deri me datë 30 Tetor 2014

9. Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Vlorë, bazuar në të dhëna të sakta, rakorduar me zyrën e gjendjes civile dhe verifikimin në fakt, të hartojë regjistrat për taksapaguesit familjarë, duke ndjekur dhe arkëtuar edhe detyrimet e periudhave të mëparshme si dhe të rakordojë të dhënat e regjistruara, duke i pasqyruar ato në bilancin kontabël të institucionit.

Deri me datë 30 Shtator 2014

10. Të bëhet saktësimi i gjobave të vendosura nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të kontabilizohen shumat me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e tyre. Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e gjobave të vendosura konkretisht për vitin 2012 ndaj 13 subjekteve në shumën 325,000 lekë dhe për vitin 2013 ndaj 48 subjekteve në shumën 1,250,000 lekë, pasi sipas verifikimit asnjë nga subjektet nuk ka arkëtuar detyrimet për vendosjen e gjobave.

Deri me datë 30 Korrik 2014

11. Nga ana e Drejtorisë së Taksave, Policisë Bashkiake dhe Drejtorisë Juridike, të merren masa duke propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, sipas kërkesave të nenit 6 “*Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative*” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “*Për kundërvajtjet administrative*”.

Në mbledhjen më të afërme të Këshillit Bashkiak

12. Të merrem masa dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për kryerjen e kontroleve dhe rivlerësimin e xhiros së subjekteve të cilët kanë deklaruar xhiro nën vlerën 2,000,000 lekë, me qëllim përcaktimin e saktë të detyrimit mbi xhiro.

Deri me datë 30 Korrik 2014

13. Të merren masa që në bashkëpunim me ZVRPP Vlorë, të përfundojë procesi i regjistrimit të aseteve në administrim të Bashkisë Vlorë (sipas statusit të përcaktuar në VKM përkatëse) dhe të pasqyrohet evidenca e tyre në kontabilitet.

Vazhdimisht

14. Në pozicionin e Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor të Bashkisë, të vendoset një punonjës i arsimuar në fushën e ndërtimit, pasi emërimi i punonjësit aktual i cili rezultoi të ketë **përfunduar shkollën për oficer rezervist** (2 vjeçare Bunavi) dhe administrim biznesi në vitin 2009 Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 11 “*Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit ndërtimor urbanistik*” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për Inspektimin e Ndërtimit*”.

Brenda datës 30.07.2014.

15. Nga ana e Bashkisë Vlorë, të ngrihet një grup pune me punonjës të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Shërbimeve Publike, dhe Njësive administrative, etj, për të kryer një evidentim dhe inventarizim të përgjithshëm për gjendjen e ndërtimeve në qytet sipas fazave, llojeve të ndërtimeve, **strukturës së ndërtimeve pa leje**, si dhe të krijohet database me të dhënat e nevojshme, me qëllim inventarizimin e secilës rrugë e lagje.

Pas hartimit të procesverbaleve, nga inspektorët për secilin rast, ti bëhen propozim me shkrim, Kryeinspektorit, për vendosjen e sanksioneve, siç përcaktohet në nenin 15 paragrafi i fundit të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”.

Deri më datën 30 Shtator 2014

16. Nga ana e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Vlorë, në bashkëpunim me 5 Rajonet, të evidentohen të gjitha objektet të cilët kanë kryer ndërtime të kundërligjshme dhe veçanërisht **11 subjektet ndërtuese të cituara në rekomandimin nr. 16**, më poshtë dhe subjektet e tjera që do rezultojnë gjatë verifikimit në teren, të cilat nuk janë pajisur me lejë zhvillimi, ndaj tyre, të vazhdojnë procedurat ligjore të parashikuara, në ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “*Për planifikimin e territorit*” me ndryshime.

Deri me datë 30 Shtator 2014

17. Duke qenë se 4 subjektet ndërtuese të cilët sipas të dhënave të mara nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, kanë filluar e përfunduar punimet, pa u zbardhur leja e ndërtimit, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “*Për urbanistikën*”, të ndryshuar dhe VKB Vlorë nr. 62, datë 26.11.2009 “*Për taksat dhe tarifatat vendore*”, të ndryshuar.

Për sa sipër, mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “*Kodi i procedurave administrative*”, pjesa VI, kreu I dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin në rrugë ligjore të të ardhurave të munguara në buxhetin e Bashkisë Vlorë në vlerën **30,506,922 lekë duke llogaritur edhe kamatëvonesat**, për 4 subjekte ndërtuese të paraqitura hollësisht në këtë pasqyrë:

	Vendimi KRRT	Vlera që	Arkëtuar	Pa
--	--------------	----------	----------	----

Nr	Emërtimi i subjektit	Nr.	Datë	duhet të paguanin	Deri 31.12.2013	Arkëtuar 30.04.2014
1	“ A... Konstruksion”	7/61	07.09.10	5,591,663	0	5,591,663
2	“S...Konstruksion”	2/182	28.09.11	8,570,147	5,000,000	3,570,147
3	“A..I”	2/230	28.09.11	12,218,956	50,000	12,168,956
4	“F...Invest”	2/52	07.09.10	12,518,380	3,342,224	9,176,156
	Shuma			38,899,146	8,392,224	30,506,922

Në mënyrë analitike për secilin subjekt paraqitet si më poshtë:

a-Subjekti ndërtues “A...Konstruksion” me vendimin e KRRT, nr. 7/61, datë 07.09.2010, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin (**përfunduar**) e “Godinë banimi dhe shërbimi 2-5-6-7-8 kate, me 1 kat nëntokë, “Lagje”Kushtrimi”

Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është **5,591,663 lekë**. Nuk ka arkëtuar asnjë vlerë monetare.

b-Subjekti ndërtues “S.P. & G... Konstruksion” me vendimin e KRRT, nr. 2/182, datë 28.09.2011, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin (**përfunduar**) Godinë banimi **10-11 kate**, me 1 kat parkim nëntokë. Lagje “Skelë”. Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 8,570,147 lekë. Arkëtuar 5,000,000 lekë. Arkëtuar më pak **3,570,147 lekë**.

c-Subjekti ndërtues “A..I” me vendimin e KRRT, nr. 2/230, datë 28.09.2011, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin. Godinë banimi dhe shërbimi **2-10 kate**, me 1 kat nëntokë. Lagje “Lef Sallata”. Vlera e llogaritur për t’u paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 12,218,956 lekë. Arkëtuar 50,000 lekë. Arkëtuar më pak **12,168,956 lekë**.

ç-Subjekti ndërtues “F...Invest” me vendimin e KRRT, nr. 2/52, datë 28.09.2011, me dosje në plotësim dokumentacioni, ka nisur ndërtimin (**përfunduar**) godinë banimi **5-8-11 kate**, kati i parë pjesërisht dyqane+ 1 kat parkim nëntokë. Lagje “28 Nëntori”. Vlera e llogaritur për tu paguar për taksën e ndikimit në infrastrukturë është 12,518,380 lekë, nga e cila është arkëtuar 3,342,224 lekë dhe nuk është arkëtuar shuma **9,176,156 lekë**.

Deri me datë 30 Shtator 2014

18. Dosjet teknike, që dërgohen nga subjektet e ndërtimit në zyrat e Inspektoratit ndërtimor Urbanistik dhe të pranohen pasi të jenë protokolluar dhe shoqëruar me listën e përmbajtjes së dokumentacionit. Ndërkohë të kryhet Inventarizimi i dosjeve për gjithë periudhën, të cilat janë gjendje fizike në zyrat e inspektoratit ndërtimor urbanistik siç përcaktohet në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.

Vazhdimisht

19. Nga ana e inspektoratit Ndërtimor Urbanistik në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, dhe Drejtorinë e Buxhet-Financës, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” pikës 16 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor” (Ndryshuar me VKM nr . 625, datë 28.7.2010), VKM 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e Planit Kontabël Publik”, VKM nr. 25, date 20.01.2001 “Për një ndryshim në VKM 248 date 10.04.1998 “Për miratimin e Planit Kontabël Publik”, Udhëzimet e Ministrisë së Financave nr . 14, date 28.12.2006 dhe nr. 26, date 27.12.2007 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare”, Plani Kontabël Publik, klasifikimi buxhetor **-Llogaria 7 115 409, të merren masa për:**

a. Hartimin e akt rakordimit dhe Regjistrimin në kontabilitet të vlerës së gjobave të vendosura nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik i Bashkisë Vlorë.

b. ndjekjen e procedurave ligjore dhe vënien në arkëtim të 51 gjobave në vlerën 11.650.000 lekë, duke llogaritur edhe kamatëvonesat 2% në ditë, deri në 1 muaj, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të vendosura nga ana e INUV të Bashkisë Vlorë, për periudhën 01.01.2011-18.06.2012, lista sipas **Aneksit nr. 13.**

c. ndjekjen e procedurave ligjore dhe vënien në arkëtim të 131 gjobave në vlerën 51.352.000 lekë, duke llogaritur edhe kamatëvonesat 2% në ditë, deri në 1 muaj, bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të vendosura nga ana e INUV të Bashkisë Vlorë, për periudhën 18.06.201-31.12.2013, lista sipas **Aneksit nr. 12.**

d. Të merren masa dhe të rakordohet në bashkëpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për gjendjen dhe ndjekjen e ecurisë së 67 kallëzimeve penale, të dërguara për vitet 2010 -2013.

Menjëherë e në vazhdim

20. Për të gjitha ankesat e qytetarëve dhe kërkesat e 5 njësive Administrative, të hapet një regjistër i posaçëm me të dhënat përkatëse për evidentimin dhe pasqyrimin e ankesave të qytetarëve. (Libri i protokollit të brendshëm të Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik).

Menjëherë

21. Kryetari i Bashkisë Vlorë, të ngrejë një grup pune me persona përgjegjës dhe afate konkrete, i cili të sistemojë dhe riklasifikojë gjithë dokumentacionin e Bashkisë Vlorë, duke vepruar në përputhje me ligjin nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Për Arkivat”, Rregullorja “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, Për “Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor” dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Dokumentacioni i sistemuar dhe i klasifikuar sipas afateve dhe viteve, në bashkëpunim dhe rakordim edhe me Zyrën Rajonale të Arkivit Vlorë, të dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Brenda datës 31.10.2014

22. Të fillohen procedurat ligjore për arkëtimin nga subjekti “I...D” Shpk të detyrimit në vlerë 5,231,076 lekë, që ka ardhur si pasojë e mosplotësimit të kushteve të kontratës për periudhën 1 Qershor 2012- 31 Dhjetor 2013, pasi ky subjekt ka paguar më pak nga vlera e përcaktuar në kontratë.

Deri me datë 30 Shtator 2014

23. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Vlorë, në rrugën e “Ujit të Ftohtë”, të merren masa dhe të zbatohet vija e kuqe e ndërtimit deri në 6 kate, në zbatim të Vendimit të KRRTRSH-së nr. 1, datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”.

Vazhdimisht

24. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Vlorë, të fillojë nismën për hartimin e planit vendor, planit të veprimit dhe të rregulloreve përkatëse, në zbatim të nenit 46, 53, 55, 70, të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 *“Për Planifikimin e Territorit”*, të ndryshuar.

Brenda datës 30 maj 2014

25. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashkinë Vlorë, për të gjitha objektet që do të jenë me vlerë më të madhe se 100 milion lekë, detyrimsht duhet të kërkohet opinionenca teknike, në zbatim të nenin 6, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit”*, të ndryshuar dhe pikës 1 e 3 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 *“Për vendosjen e opinionencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”*.

Vazhdimisht

26. Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Vlorë, të plotësojë dosjet individuale me: librezat e Punës, kontratën individuale të punë, diplomat, certifikatat e notave, etj, dokumentacion të përcaktuar në Aneksin e I dhe II-të, të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 *“Për organizimin e dosjes dhe regjistrin personelit”*.

Brenda datës 30.09.2014

27. Nga ana e Bashkisë Vlorë të analizohet në Këshillin Bashkiak si më poshtë:

a. Përdorimi i huasë bankare të miratuar me VKB Vlorë, nr. 27, datë 20.04.2010 për vlerën 420,000,000 lekë. Të protokollohet marrëveshja e huasë bankare me Bankën Kombëtare Tregtare, datë 21.12.2010 (e cila nuk figuronte në Zyrën e protokollit të Bashkisë Vlorë, pavarësisht se ishte noterizuar nga I.B. me nr. 2707 rep, Nr 1892/3 kol, për shumën prej 420,000,000 lekë, me afat 10 vjet.)

Nga shuma e huasë miratuar prej 420,000,000 lekë, deri më datën 31.12.2013, janë tërhequr 150,000,000 lekë, duke mbetur edhe 270,000,000 lekë. Në se vlerësohet se duhet tërhequr e gjithë vlera e huasë, të shqyrtohet kjo procedurë në Këshillin Bashkiak dhe të bëhen ndryshimet në mirëkuptim me Bankën Kombëtare Tregtare dhe në zbatim të kushteve të aktmarrëveshjes bazë të datës 21.12.2010.

b. Paaftësia paguese dhe përcaktimi i mënyrës dhe fondeve për likuidimin e faturave të palikujduara nga **25 subjekte në vlerë prej 257,444,112 lekë.**

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak

28. Nga ana e Bashkisë Vlorë, ti kërkohet Drejtorisë Policisë Prefekturës Vlorë, (Sektorit Qarkullimit Rrugor), pajisja me targë e mjeteve teknologjike që përdor shoqëria e pastrimit, “Duka”, bazuar në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor”, i ndryshuar, neni 113 pika 2 -Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike, ku përcaktohet se: Për të qarkulluar në rrugë makinat teknologjike duhen regjistruar në zyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, që i lëshojnë lejen e qarkullimit atij që vërteton se është pronari.

Menjëherë

29. Nga ana e Bashkisë Vlorë dhe 5 njësive Administrative, me përfundimin e kontingjentit të librezave të popullatës për pagesat e taksave vendore, gjendje në magazinë, për të ardhmen të prodhohen librezat me shumë fletë, duke bërë përshtatjen e tyre. Arkëtarët e 4 njësive administrative të pajisen me vula katrore të thjeshta identifikimi.

Brenda datës 30.09.2014

30. Nga ana e Bashkisë Vlorë të rizhvillohen procedurat e përzgjedhjes së inspektorëve të Policisë Bashkiake, duke zbatuar kriteret e urdhrit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003 *“Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”*, pikat 4 dhe 5.

Brenda datës 30 Gusht 2014

31. Nga Policia Bashkiake të merren masa për arkëtimin e gjobave të prapambetura, në të kundërtën të fillojnë ndalesat ndaj 9 personave të cilët i kanë vendosur dhe nuk i kanë arkëtuar 46 gjoba për në vlerën **53,500 lekë**.

Brenda datës 30 Korrik 2014

32. Për mjetet dhe pajisjet të cilat nuk janë me efektivitet dhe kanë plotësuar afatin e përdorimit, duke përfshirë edhe (Ndërmarrjen e Shërbimeve), të përgatitet dokumentacioni për vlerësimin e efektivitetit të tyre, duke zbatuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, respektivisht kuadri ligjor i përcaktuar në pikat 95-119 dhe 120, për efektet ekonomike dhe financiare. Po ashtu të informohet edhe Këshilli Bashkiak mbi këto procedura.

Brenda datës 30 Shtator 2014

33. Sektori i Strehimit në Bashki, të kryhet bashkimi i gjithë dokumentacionit të përfituesve të kredisë, inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të përfituesve të kredisë pranë zyrës së arkivit, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 *“Për Arkivat”*. Rregullorja *“Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”*, Për *“Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor”* dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Brenda datës 30 Shtator 2014

34. Sipas VKM nr. 660, datë 12.09.2007 *“Për transferimin e aksioneve të Shoqërive të Ujësjellësve dhe Kanalizimeve Njësive të Qeverisjes vendore”*, një pjesë e aksioneve të Ujësjellësit sh.a, Vlorë i ka kaluar Bashkisë ku edhe Këshilli Mbikëqyrës caktohen nga Këshilli Bashkiak Vlorë. Për këtë arsye nga ana e Bashkisë Vlorë, të përgatitet aktmarrëveshja për pagesën e taksave dhe tarifave nga popullata, së bashku me faturat ujë të pijshëm, nëpërmjet Ujësjellës sh.a, Vlorë, e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.

Kjo bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* i ndryshuar, neni 5, -Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, këshilli i bashkisë ose i komunës, sipas shkronjës ii) -përcakton mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjella; nenin 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore”* i ndryshuar, pikës 7.1, të UMF, nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për Procedurat Tatimore”*.

Në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në vartësi të Bashkisë Vlorë

34. Të merren masa për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”. Për këtë:

-Të rishikohet struktura organizative me synim reduktimin e numrit të punonjësve në përputhje me mundësitë financiare të bashkisë.

- Të miratohet strategjia e risku dhe të hapet regjistri i tij, ku të evidentohen parregullsitë dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit.

-Të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, sipas kërkesave të Kap. III-të të UMF nr. 30, datë 27/12/2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

35. Të plotësohen regjistrat e aseteve me karakteristikat për çdo objekt dhe të nënshkruhen nga personat përgjegjës, bazuar në inventarët e objekteve të paraqitura në llogarinë 215 “*Mjete transporti*”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

36. Shpërndarja e karburantit të bëhet për çdo rast në karakteristikat e automjeteve bazuar në targat dhe tipin e automjetit në emrin e personit që ka në ngarkim dhe përdorim automjetin. Normat e harxhimit të karburantit për 100 km të bazohen në të dhënat e librezës për volumin e cilindrit së automjeteve dhe kohën e përdorimit të mjetit.

Vazhdimisht

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën 83,185,796 lekë, si më poshtë:

1. Vlera 341,100 lekë, janë kryer pagesa për shpërblimin e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioneve të vlerësimit të ofertave në prokurimin elektronik për vitin 2011 në vlerën 204,300 lekë dhe vitin 2012 në vlerën 136,800 lekë, pagesa këto të pa mbështetura në dispozita ligjore dhe të pa justifikuara, mbasi këta punonjës e kanë detyrën e tyre funksionale dhe të gjitha praktikatat e zhvillimit të tenderëve zhvillohen brenda orarit të punës. (Për këtë është mbajtur proces verbali nr. 6, datë 14.01.2014, dhe listat sipas Aneksi nr. 3, bashkëlidhur.

Brenda datës 30 Shtator 2014

2. Vlera 357,600 lekë, është kryer pagesë me urdhër shpenzimin nr. 506, datë 01.11.2013, shpenzime për drekën e organizuar me rastin e Vitit të Ri 2012, për 149 punonjës x 1614 lekë/person, punonjës të administratës së bashkisë. Shpenzimet e kryera janë në kundërshtim me VKM nr. 589, datë 05.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012”, pika 5, ku përcaktohet: “....Fondi i veçantë, i planifikuar në njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk përdoret për veprimtari social kulturore dhe shpërblime deri më datën 5 dhjetor 2012”. Aneksi nr. 3, bashkëlidhur.

Brenda datës 30 Shtator 2014

3. Vlera 432,505 lekë sepse janë përballuar pagesa për telefoninë e lëvizshme 17 personave, në kundërshtim me pikën 9, lidhja nr. 6 pika 2 të VKM 864 datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave, publikë”, pasi paga e personave që kanë përfituar për vitin 2011 është në nën nivelin e Klasës II-B të klasifikimit të pagave në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, ...”. Aneksi nr. 3, bashkëlidhur.

Brenda datës 30 Shtator 2014

4. Vlera 200,050 lekë, paguar Operatori Ekonomik “E...” shpk. për volume pune të pa kryera dhe të raportuara si të kryera në situacionin përfundimtar për riparimin e një magazine. Kjo pagesë është kryer në kundërshtim me kontratën, nenet 8 dhe 11, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe Kreun I-rë pika 8.3 të UKM, nr. 2, datë 13.05.2005, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

5. Vlera 5,231,076 lekë, nga subjekti “I...” shpk, për ulje të sipërfaqes të objektit të dhënë me qira duke e ndarë dhe parcelizuar objektin pa dokumentacion të argumentuar të bazuar me matje faktike, por në një genplan të përgjithshëm bashkëngjitur kontratës për periudhën 1 Qershor 2012-31 Dhjetor 2012.

Brenda datës 30 Shtator 2014

6. Vlera 31,850 lekë, nga subjekti “J...” shpk, diferencë e paguar më pak nga qiraja vjetore.

Brenda datës 30 Shtator 2014

7. Vlera 30,000 lekë, ndaj z. D.Z. me detyrë Jurist në Bashkinë Vlorë, sa paguar në Ndërmarrjen e Shërbimeve për komisione marrje pjesë në tendera. Pagesë kjo e pa mbështetur në dispozita ligjore dhe e pa justifikuar, mbasi ky punonjës është i punësuar në Bashkinë Vlorë, Drejtorinë Juridike dhe të gjitha praktikat e zhvillimit të tenderëve duhet të kryhen brenda orarit të punës.

Brenda datës 30 Shtator 2014

8. Ndaj 15 operatorëve ekonomikë në vlerën 1,996,689 lekë, për arsye se janë shpallur fitues në tenderat e zhvilluar, ndërkohë në preventivin e paraqitur në tender, si pjesë e ofertës ekonomike dhe në situacionin përfundimtar zërat e punës “pajisje” i kanë llogaritur me vlerën e TVSH, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, duke përfituar padrejtësisht 16 operatorët ekonomikë, si më poshtë:

- Nga operatori ekonomik “A...” të arkëtohet **vlera 220,600 lekë**, pasi është shpallur fitues dhe lidhur kontrata viti 2013 për objektin “Sistemimi i trotuareve në qytet” me të metat e cituar më sipër.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- Nga operatori ekonomik “M...” të arkëtohet **vlera 42,400 lekë** pasi është shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 09.08.2012 për objektin “Rikonstruksion i shkollës Muço Delo” me të metat e cituar më sipër.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- Nga operatori ekonomik "G..." të arkëtohet **vlera 60,840 lekë**, pasi është shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 13.06.2012 për objektin **"Rikonceptim i sheshit Pavarësia Vlorë, Faza I"**, me të metat e cituar më sipër.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- Nga operatori ekonomik "Gj..." të arkëtohet **vlera 118,992 lekë**, pasi është shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 02.07.2012 në tenderin me objekt **"Rikonceptim i sheshit Pavarësia Vlorë, Faza II"**, me të metat e cituar më sipër.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- Nga operatori ekonomik "F..." të arkëtohet **vlera 582,445 lekë**, pasi është shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 03.08.2012, në tenderin e zhvilluar me objekt **"Rikonceptim i sheshit të flamurit"**, me të metat e cituar më sipër.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 209,850 lekë**, pasi operatori ekonomik "B...", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata viti 2012, në tenderin e zhvilluar me objekt **"Sistemimi dhe gjelbërimi i bllokut të banimit tek pallatet e Gorishtit dhe lulishtja në hyrje të qytetit"**.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 170,436 lekë**, pasi operatori ekonomik "Sh...", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 06.05.2011, me objekt **"Sistemim asfaltim i bllokut të pallatet e Gorishtit"**.

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 108,000 lekë**, pasi operatori ekonomik "B...", i shpallur fitues dhe lidhur kontratat datë 06.05.2011, në tenderin me objekt **"Sistemim zgjerim i trotuarit dhe ambienteve të gjelbërta në rrugën "Çamëria" dhe "Murat Terbac"**,

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 185,600 lekë**, pasi operatori ekonomik "A...", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 17.05.2011, në tenderin me objekt **"Sistemim asfaltim blloku nr.1 në lagjen "Isa Boletini", Rajoni nr.2 (zona nga rruga Mustafa Bello -QTS -Rruga e Unazës-rruga Sadik Zotaj"**,

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 40,360 lekë**, pasi operatori ekonomik "N...", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 29.03.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt **"Rikonstrukcion i rrugës Vasil Talo"**,

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 54,360 lekë**, pasi operatori ekonomik "D...", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 05.04.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt **"Rikonstrukcion i rrugës Zahir Pajaziti"**,

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 57,440 lekë**, pasi operatori ekonomik "A... Konstrukcion", i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 31.03.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt **"Rikonstrukcion i rrugës Dervish Hekali dhe Enriko Veizi"**,

Brenda datës 30 Shtator 2014

- **Vlera 67,200 lekë**, pasi operatori ekonomik "K...", i shpallur fitues lidhur kontrata datë 27.04.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt **"Sistemim asfaltim rrugës Dr. Pavllo Flloko të 7 pallatet"**,

Brenda datës 30 Shtator 2014

-**Vlera 24,166 lekë**, pasi operatori ekonomik “H...”, i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 29.03.2011 në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i rrugës Zahir Pajaziti dhe Bilal Golemi”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-**Vlera 54,000 lekë**, pasi operatori ekonomik “L...”, i shpallur fitues dhe lidhur kontrata datë 28.04.2011, në tenderin e zhvilluar me objekt “**Sistemim i bllokut Bashki-Rruga Demokracia**”,

Brenda datës 30 Shtator 2014

9. Nga 12 persona në **shumën 64,416 lekë**, për tejkallim të normativave të konsumit karburantit sipas listës, punonjësve në Ndërmarrjen e Shërbimeve Bashkia Vlorë, lista e përcaktuar në proces verbalin nr. 1 datë 12.03.2013 mbajtur në këtë ndërmarrje.

Brenda datës 30 Shtator 2014

10. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, nga 7 subjekte pasi nuk kanë paguar apo u është llogaritur më pak taksa e ndikimit në infrastrukturë. Në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar dhe VKB Vlorë nr. 62, datë 26.11.2009 “Për taksat dhe tarifatat vendore”, të ndryshuar, në vlerën **3,999,025 lekë**, si më poshtë:

-Subjekti ndërtues “D...” sh.p.k në shumën **141,112 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Subjekti ndërtues “E...” sh.p.k në shumën **118,523 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Subjekti ndërtues “A...” sh.p.k në shumën **865,709 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Subjekti ndërtues “D...” sh.p.k në shumën **22,000 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Subjekti ndërtues “M...” sh.p.k në shumën **2,851,716 lekë**, llogaritur më pak taksë ndikimi në infrastrukturë dhe studim urbanistik.

Brenda datës 30 Shtator 2014

11. Nga Bashkia Vlorë, të merren masa dhe të ngrihet grup pune për të vlerësuar dhe llogaritur vlerën e punimeve të pakryera në objektin “Sistemim i bulevardit Vlorë - Skelë” nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B...” sh.p.k & “A... impex” shpk, në **vlerën 7,051,627 lekë**, (pasi subjekti po vazhdon të kryej punime në objekt aktualisht), duke bërë sistemimet e nevojshme.

Brenda datës 30 Shtator 2014

12. Në **vlerën 18,175,952 lekë**, për punime të pakryera nga 8 operatorët ekonomikë, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin

dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe kontratat përkatëse. Trajtuar më hollësisht në pikën 6/1-Zbatimi i kontratave, faqen 130-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë:

-Në vlerën 451,485 lekë, ndaj Operatorit Ekonomik “J...” sh.p.k për dëmin ekonomik e shkaktuar, për punime të pakryera në objektin “Shërbimi i Mirëmbajtjes së Gjellbërimit”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 957,620 lekë, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “A...” sh.p.k & “A...” shpk & “S...” shpk për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “Rikonstruksion i bllokut nr. 1, Lagjja “Isa Boletini””.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 302,400 lekë, ndaj Operatorit Ekonomik “B...” sh.p.k për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “Sistemimi dhe gjellbërimi tek pallatet e Gorishtit dhe lulishtja në hyrje të qytetit”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 409,850 lekë, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B...” sh.p.k & “C...” shpk për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “Rruga “Gjergj Araniti” në veri të kombinatit”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 4,028,080 lekë, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “L...” sh.p.k & “C...” shpk për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “Sistemim i rrugës Topana – Kuzum Baba”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 1,492,596 lekë, ndaj Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “Sh...” sh.p.k & “A...” shpk për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “S.A. blloku i pallateve të Gorishtit”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 431,671 lekë, ndaj Operatorit Ekonomik “F...” sh.p.k për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “Rikonceptim i sheshit të Flamurit”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

-Në vlerën 10,102,250 lekë, ndaj Operatorit Ekonomik “Gj...” sh.p.k për dëmin ekonomik, për punime të pakryera në objektin “Rikonceptim i sheshit Pavarësia”.

Brenda datës 30 Shtator 2014

13. Nga Bashkia Vlorë , të merren masa dhe të kërkohet e ndiqen të gjitha proceduart administartive dhe ligjore për arkëtimin e dëmin ekonomik **në vlerën 44,499,901 lekë**, nga operatori ekonomik “D...” sh.p.k, për punime të pakryera në zbatimin e kontratës për “Shërbimin e Pastrimit Urban të qytetit”, veprim ky në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

D.MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës”*, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003, ligjit për *“Nëpunësin Civil”* dhe shkronjave a, b dhe c të nenit 9 *“Kontratat individuale të punës”*, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vlorë, që bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, i ndryshuar, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 70 punonjësit, si më poshtë:

a. Vërejtje me paralajmërim për “Zgjidhje e kontratës individuale të punës”, për 38 punonjësit e mëposhtëm;

1. **B.H.**, me detyrë inspektore e kontabilitetit tatimor
2. **N.M.**, me detyrë faturiste në Rajon, për taksat dhe tarifatat familjare
3. **K.B.**, me detyrë faturist në Rajon për taksat dhe tarifatat familjare
4. **H.S.**, me detyrë faturiste në Rajon për taksat dhe tarifatat familjare
5. **A.Gj.**, me detyrë faturiste në Rajon për taksat dhe tarifatat familjare
6. **L.M.**, me detyrë faturiste në Rajon për taksat dhe tarifatat familjare,

Për shkeljet e mëposhtme:

-nuk kanë zbatuar kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* të ndryshuar, me ligjin nr. 9745 datë 28.05.2007 në programimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore si dhe nga rritja nga viti në vit e gjendjes detyrimeve debitore në total në vlerën **340,190 mijë** lekë dhe konkretisht:

-nuk kanë ndjekur të gjitha procedurat ligjore, për subjektet debitore sipas viteve 2011-2013, si bllokime apo sekuestrime, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake dhe me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve deri në kërkesa dhe ndjekje ligjore në rrugë gjyqësore.

-nuk janë evidentuar të veçanta arkëtimet për detyrime nga taksat dhe tarifatat e mbartura nga vitet e mëparshme duke u paraqitur dhe evidentuar si arkëtime në vitin ushtrimor.

-nuk janë hartuar me të dhëna të plota regjistrat me emrat respektiv të K/familjarëve dhe pasuritë përkatëse të rakorduara me ZVRPP për detyrimet dhe arkëtimet e kryera sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9745 datë 28.05.2007 *“Për sistemin e taksave vendore”*

-nuk është aplikuar dhe arkëtuar, megjithëse është vendosur për familjarët në masën 500 lekë/familje, tarifa shërbim ndriçimi dhe gjelbërim qyteti, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë për vitet 2012-2013.

-nuk janë paraqitur si detyrime në bilancet kontabël për vitet 2011 e në vazhdim, shumatat e pa arkëtuara nga taksat vendore sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”* të ndryshuar, me ligjin nr. 9745 datë 28.05.2007 dhe në ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*.

- nuk kanë zbatuar urdhrin e Kryetarit të Bashkisë z. Shpëtim Gjika, nr. 9, datë 16.02.2012 *“Mbi zbatimin e VKB nr. 21, datë 21.11.2011, pika II/2 dhe pika II/4, “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme dhe tarifën vjetore të pastrimit urban”*.

7. M.T., specialiste e sektorit të administrimit dhe mbrojtjes tokës, pasi:

- nuk ka azhurnuar e përditësuar, hartat e njollosura me sipërfaqet përkatëse për tokën truall kaluar me Vendimin nr. 1/4 datë 18.4.2008 nga KKRRTSH, për sipërfaqen 198 ha, nga e cila 166 ha është tokë bujqësore, përfshirë rajonet nr. 1 dhe 2 të Bashkisë, për të cilat nuk ka verifikime e të dhëna në terren, për administrimin këtyre pronave.

-nuk ka dokumentacion për verifikimin dhe azhurnimin e sipërfaqeve të 760 objekteve të privatizuara, në territorin në administrim të Bashkisë Vlorë, të dërguara nga Qarku Vlorë, ish dega e AKP Vlorë dhe Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit Vlorë protokolluar në bashki me nr. 89, prot. datë 16.1.2008, drejtuar për zbatim drejtorisë urbanistikës, drejtorisë juridike dhe drejtorisë financës, si dhe nuk janë ndjekur arkëtimet për qiratë apo shitje të trojeve për këto objekte.

8. D.S., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, pasi:

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 18, 20, 21, 22, 23, 27, 29, 40, 41, 44, 61, të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 *“Për Planifikimin e Territorit”*, të ndryshuar, neni 9 e 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.06.2011, Për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve”* dhe nenin 73 e 74 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 *“Për planifikimin e territorit”*, të ndryshuar, nenin 86 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Proceduarve Administrative”*, nenin 3, 7, 8 dhe 11, të ligjit nr. 8503, datë 30.06.1999 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”*, pikën 4 të nenit 16, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”* dhe nenin 45, të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”*, të ndryshuar.

9. N.R., me detyrë specialiste për kontrollin teknik, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, pasi:

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e nenit 9 e 13, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, të ndryshuar, UKM nr. 1, datë 16.06.2011, për disa ndryshime në UKM nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve”*.

Trajtuar në pikën 8 dhe faqet 164-214 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

10. J.H., me detyrë juriste nga data 11.06.2012, në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, pasi:

-Për shkeljet e kryera në moszbatimin e pikës 4 të nenit 16 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*, neni 253 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile”*, të ndryshuar, nenin 20, 22/2, 45, 46, të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 *“Për Urbanistikën”*, të ndryshuar, pikën 1 të nenit 29 dhe nenin 47, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 *“Për trashëgiminë kulturore”*, të ndryshuar dhe Kreu III, të VKM nr. 795, datë 26.11.2003 *“Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të komisionit të përhershëm të vlerësimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedurat e vlerësimit të këtyre objekteve”*, pikën 47, 63 dhe 66, 85, 127, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 *“Për miratimin e rregullores së urbanistikës”*, vendimin e KRRTRSH-së nr. 1,

datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”.

11. H.H., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Ekonomik

12. A.Sh., Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit, pasi:

-kanë lejuar të krijohen fatura të palikujduara nëpërmjet kryerjes punimeve, shërbimeve apo blerjes së mallrave, pa u siguruar më parë fondet e nevojshme duke krijuar paaftësi paguese nga 25 subjekte në vlerën **prej 257,444,112 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, neni 50 “Angazhimet buxhetore” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu V pika 1 germa (ç), pasi zhvillimi i tenderëve dhe lidhja e kontratës dhe realizimi i shërbimeve apo blerja e mallrave është kryer pa pasur fondet në dispozicion.

-Për mos krijimin e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme ku të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si; data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj, në kundërshtim me Kap.III-të - Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Kanë lejuar të kryhen pagesa në vlerën 341,100 lekë, për shpërblimin e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisioneve të vlerësimit të ofertave në prokurimin pagesa këto të pa mbështetura në dispozita ligjore dhe të pa justifikuara.

-Kanë lejuar të kryhen pagesa në vlerën 357,600 lekë, shpenzime për drekën e organizuar me rastin e vitit Ri 2012, për 149 punonjës x 2400 lekë/person Pasi këto lloj shpenzimesh ndaloheshin nga pika 5 e VKM nr. 589, datë 05.09.2012 “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2012”.

Për 9 punonjës të Policisë bashkiake të cilat kanë treguar një efektivitet të ulët të punës të tyre e për rrjedhojë dhe Policisë bashkiake, për mos ndëshkimin me gjobë për shkeljet e ndryshme, apo për vendosjen e tyre në vlerën minimale 500 lekë, në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës", si më poshtë:

13. A.H., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet nuk ka vendosur asnjë gjobë.

14. E.B., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet nuk ka vendosur asnjë gjobë.

15. A.L., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet nuk ka vendosur asnjë gjobë.

16. P.G., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet nuk ka vendosur asnjë gjobë.

17. D.C., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet nuk ka vendosur asnjë gjobë.

18. P.M., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet ka vendosur 5 gjoba me vlerë 13.000 lekë.

19. R.T., punonjës i policisë bashkiake, pasi, për 2 vjet ka vendosur 7 gjoba me vlerë 7.000 lekë.

20. A.Zh., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet ka vendosur 7 gjoba me vlerë 11.000 lekë

21. E.M., punonjës i policisë bashkiake, pasi për 2 vjet ka vendosur 4 gjoba me vlerë 6,000 lekë.

Për 3 punonjësit e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm Publik të Bashkisë Vlorë, respektivisht:

22. L.G., me detyrë Përgjegjëse e Njesisë së Auditit të Brendshëm, në cilësinë e auditueses për vitin 2011 dhe Përgjegjëse për periudhën 2 vjeçare 07.02.2012 -31.12.2013 e në vazhdim.

23. E.B., në cilësinë e ish-Drejtores së Auditit për një vit e 10 muaj viti 2011 dhe në cilësinë e auditueses për periudhën 2 vjeçare, nga data 07.02.2012-31.12.2013 e në vazhdim.

24. L.D., audituese për një periudhë 2 vjeçare, nga data 07.02.2012 -31.12.2013 e në vazhdim, *pasi:*

- Gjatë kryerjes së auditimeve, auditët nuk kanë kryer auditime nga pikëpamja profesionale, dhe nuk kanë dhënë rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë, në rastet e dëmeve ekonomike dhe financiare, për zhdëmtimin e tyre si dhe nuk kanë bërë propozime të cilët synojnë të ulin mundësinë përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen, në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 *"Për auditin e brendshëm në sektorin publik"*, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010, neni 21, *"Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm"*, pika 4.

-Nuk kanë zbatuar plotësisht Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB) të miratuar me UMF nr. 69, datë 29.9.2010.

-nuk kanë zbatuar plotësisht UMF nr. 12, datë 5.6.2012 *"Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik"*.

-nuk kanë zbatuar plotësisht detyrat funksionale të përcaktuara në nenin 33, -Njësia e Auditimit të Brendshëm, nenin 37- Përgjegjësi i Njesisë së Auditit të Brendshëm dhe nenin 38- Specialisti i Auditit të Brendshëm, përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Vlorë *"Për organizimin, funksionimin e detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë"*, miratuar me VKB nr. 40 date 17.10.2008, i ndryshuar.

Për administratoren e Qytetit dhe administratorët e 5 Rajoneve, konkretisht:

25. V.S., Administrator i Qytetit në cilësinë e anëtarit të komisionit të strehimit

26. I.A., administrator i rajonit nr. 2, në cilësinë e anëtarit të komisionit të strehimit

27. A.L., administrator i rajonit nr. 3, në cilësinë e anëtarit të komisionit të strehimit

28.A.L., administrator i rajonit nr. 4, në cilësinë e anëtarit të komisionit të strehimit

29. V.B., administrator i rajonit nr. 5, në cilësinë e anëtarit të komisionit të strehimit, *pasi:*

a)Mbledhjet e komisionit të strehimit nuk janë dokumentuar, duke mos mbajtur proces verbale në kundërshtim me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 *"Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"* Neni 16, *"Procesverbali i mbledhjes"*.

-kanë lejuar të miratohen kredi me kushte lehtësuese familjeve përfituese nga kredia e lehtësuar nga shteti me mangësi në dokumentacion,në kundërshtim me VKM nr. 574, datë 29.08.2012 *"Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesin familjet e pastreha, për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale për strehim"* me mangësi si më poshtë:

-nga 51 aplikues mungonte certifikata e lindjes së aplikantit dhe certifikata e gjendjes familjare.

-nga 13 aplikues, mungonte vërtetimi për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

-nga 3 aplikues u mungonte vërtetimi i të ardhurave neto të familjes;

-nga 51 aplikues, mungonte dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

-nga Komisioni i strehimit nuk është përdorur sistemi i pikëzimit, për përzgjedhjen e familjeve përfituese të kredisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9232, datë 12.05.2004 *“Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”*, i ndryshuar, neni 6 *“Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”*, pika 1 sipas të cilës *“Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi...”*.

b) Nga mos organizimi i punës dhe mos kontrolli kanë lejuar të mos grumbullohen të ardhurat nga taksat dhe tarifat e familjarëve në vlerën 129,878 mijë lekë, në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 9, datë 16.02.2012 *“Mbi zbatimin e VKB nr. 21, datë 21.11.2011. pika II/2 dhe pika II/4, “Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme dhe tarifën vjetore të pastrimit urban”*.

Për 4 inspektorët e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor të Bashkisë Vlorë, dhe konkretisht:

30. I.D., Inspektor në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik

31. A.S., Inspektor në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik

32. M.M., Inspektor në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik

33. R.F., Inspektor në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik, *pasi:*

-Pavarësisht se kanë një periudhë të shkurtër pune në këtë strukturë (rreth 6 muaj), këta inspektorë nuk kanë mbuluar territorin me kontroll dhe nuk kanë evidentuar dhe ndëshkuar subjektet që kanë kryer ndërtime të kundërligjshme pa u pajisur me lejë ndërtimi. Në kundërshtim me nenin neni 81/1 të ligjit nr. 10119 datë 23.4.2009 *“Për planifikimin e territorit”*, ku përcaktohet se: *“Inspektimi ka për mision bazë parandalimin e zhvillimeve të paautorizuara në territor apo të shkeljeve të kushteve të lejeve, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji”*.

Për 3 punonjës të Drejtorisë Juridike dhe Sektorit të Shpronësimeve dhe Administrimit të Aseteve dhe konkretisht:

34. D.Z., me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë Juridike deri më datë 05.04.2010, aktualisht Jurist në këtë Drejtori.

35. D.Ç., ish specialiste e sektorit të shpronësimeve dhe administrimit të asetëve, aktualisht Drejtore e Informacionit & Marrëdhënieve me Publikun.

36. E.H., specialist i sektorit të shpronësimeve dhe administrimit asetëve, *pasi:*

-nuk kanë evidentuar dhe paraqitur të plota në regjistra dhe në inventar në zbatim të plotë me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* kreu III *“Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”* pikat 26, 30 shkronjat *“a” “b” “c”* dhe pika 36.

-është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 430, datë 9.7.1998, *“Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive apo institucioneve shtetërore”*, VKM nr. 169 datë 13.3.2003, VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 *“Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”*, dhe me VKM nr. 529, datë 08.06.2011 pasi në asnjë rast nuk është marrë konfirmim nga ZVRPP dhe AKKP, pasi në

rastin e dhënies me qira të objektit të përmendur kërkohet detyrimisht të verifikohet gjendja juridike e sipërfaqes së dhënë me qira.

- në rastin e lidhjes Aneks Kontratë, datë 3 Korrik 2013 është ulur sipërfaqja e objektit të dhënë me qira si rezultat i zbritjes në total të 4,222 m², pa u pasqyruar dhe bazuar me matje faktike dhe me dimensione të përcaktuara, por në një genplan të përgjithshëm duke u copëzuar në parcela të veçanta objekti i plotë i dhënë me qira sipas VKB nr.102 datë 24.12.2001 *“Mbi dhënien me qira të Parkut Lojërave”*.

- nuk janë filluar procedurat për zgjidhjen e kontratës me subjektin “I...” shpk nisur nga fakti se për periudhën 1 Qershor 2012- 31 Dhjetor 2013, ky subjekt ka **paguar më pak 5,231,076 lekë** nga vlera e përcaktuar në kontrata, sipas **nenit 7** “Zgjidhja e kontratës” pika 7.2 germa “c” ku përcaktohet se kontrata mund të zgjidhet para afatit kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të saj.

- nuk janë azhurnuar e përditësuar, hartat e njollosura me sipërfaqet përkatëse për tokën truall kaluar me Vendimin nr. 1/4 datë 18.4.2008 nga KKRRTSH, për sipërfaqen 198 ha, nga e cila 166 ha është tokë bujqësore, përfshirë rajonet nr. 1 dhe 2 të Bashkisë, për të cilat nuk ka verifikime e të dhëna në terren, për administrimin këtyre pronave.

- nuk ka dokumentacion për verifikimin dhe azhurnimin e sipërfaqeve të 760 objekteve të privatizuara, në territorin në administrim të Bashkisë Vlorë, të dërguara nga Qarku Vlorë, ish dega e AKP Vlorë dhe Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe Ushqimit Vlorë protokolluar në bashki me nr. 89, datë 16.1.2008, drejtuar për zbatim drejtorisë urbanistikës, drejtorisë juridike dhe drejtorisë financës, si dhe janë ndjekur arkëtimet për qiratë apo shitje të trojeve për këto objekte.

37. F.M., specialist i nivelit të lartë agronom,. në drejtorinë e Infrastrukturës dhe Zbatimit Projekteve i ngarkuar me detyrën e mbikëqyrës së shërbimit të Gjelbërimit dhe Dekor Funeralit, *pasi*:

- nga mos kontrolli i punimeve ka lejuar të situacionohen dhe likuidohen punime të pakryera në objektin *“Shërbimi i Mirëmbajtjes së Gjelbërimit”* në vlerën **451,485 lekë** dhe në objektin *“Sistemimi dhe gjelbërimi tek pallatet e Gorishtit dhe lulishtja në hyrje të qytetit”* në vlerë **302,400 lekë**.

38. H.SH., me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të Bashkisë, *pasi*:

- ka miratuar pa përcaktuar saktë volumet e punës në ton dhe m³ por në rrugë në të gjithë rastet e transportit të dherave gjatë pastrimit të linjave dhe pastrimit të pusetave të ujrave të zeza dhe të bardha, sipas kriterëve në zbatim të plotë UKM nr. 2, datë 8.5.2003 *“Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”* dhe neni 3 dhe 5, i ligjit nr. 8402, datë 17.9.1998 *“Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*.

- ka miratuar pa përcaktuar saktë me emërtime procesverbalet gjatë matjeve të konsumit të karburantit, distancat e përshkuara të rrugës, në udhëtim brenda dhe jashtë qytetit si dhe të volumeve të punës së kryer bazuar në nenin 8 *“Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”* të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.

- ka lejuar të hartohen fletë daljet e magazinës për karburantin, në fund të muajit, në një fletë përmbledhëse për të gjithë personat që kanë tërhequr karburant, sipas urdhër dorëzimeve, ku është përcaktuar vetëm emri i personit të autorizuar për tërheqjen e karburantit pa përcaktuar llojin, tipin e mjetit dhe targën pa vepruar në zbatim të plotë me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* pikat 34, 35 germa “a” dhe “b”, 37 dhe 39.

-nuk ka ushtruar kontrole periodike për dokumentimin dhe administrimin e karburantit, krahasuar me fletët e udhëtimit të administruara.

b. Kalimi në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët për një periudhë 1 vjeçare, për 3, personat e mëposhtëm:

1. A.M., me detyrë zv/kryetar i Bashkisë, në cilësinë ish kryetarit i Komisionit të Strehimit, **pasi:**

Megjithëse pranon se **Komisioni i Strehimit** është mbledhur dhe ka shqyrtuar materialet e personave që kanë paraqitur kërkesa për kredi lehtësuese, këto mbledhje nuk janë dokumentuar, duke mos mbajtur proces verbale **në kundërshtim me** ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” Neni 16/1, Procesverbali i mbledhjes, ku përcaktohet se: Ne çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku behet një përmbledhje e gjithçkaje u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.

Komisioni i strehimit nuk ka zbatuar Rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë, miratuar me VKB nr. 11, datë 11.29.03.2012, neni 145 shkronja c Komisioni i Strehimit, ku në detyrat e këtij komisioni përcaktohet se:

1. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe trajton kërkesat e qytetareve të cilët kanë Statusin e të Pastrehut, të paraqitura në sektorin e strehimit.

2. Komisioni i Strehimit merr vendime me shkrim për problemet që trajton dhe vlerëson.

3. Vendimi i Komisionit të Strehimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij dhe miratohet nga Kryetari i Bashkisë.

4. Vendimi i Komisionit të Strehimit shqyrtohet në Këshillin Administrativ të Bashkisë dhe paraqitet me pas si projekt-vendim për miratim në Këshillin e Bashkisë.

-Nga mos shqyrtimi i dokumentacionit në komisionin e strehimit janë miratuar kredi me kushte lehtësuese familjeve përfituese nga kredia e lehtësuar nga shteti me mangësi në dokumentacion, në kundërshtim me VKM nr. 574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesin familjet e pastreha, për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale për strehim” me mangësi si më poshtë:

-nga 51 aplikues mungonte certifikata e lindjes së aplikantit dhe certifikata e gjendjes familjare.

-nga 13 aplikues, mungonte vërtetimi për vendbanimin në bashkinë ku kërkohet strehimi ose lejen e banimit, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit;

- 3 aplikues u mungonte vërtetimi i të ardhurave neto të familjes;

-nga 51 aplikues, mungonte dokumentacionin përkatës nga punëdhënësi për detyrën dhe të ardhurat e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;

- nga Komisioni i strehimit **nuk është përdorur sistemi i pikëzimit**, për përzgjedhjen e familjeve përfituese të kredisë, në kundërshtim me ligjin nr. 9232, datë 12.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar me ligjin nr. 54/2012, neni 6 “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve”, pika 1 sipas të cilës “Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi...”

d) Kanë miratuar kredi me kushte lehtësuese për qytetarin **Sh.B.**, që nga dokumentacioni i administruar në dosje deri në datën 27.07.2012, rezulton të ishte subjekt privat.

2. D.M., Specialiste e Strehimit, në cilësinë e anëtares së komisionit të strehimit, **pasi:**

-përveç shkelleve trajtuar në shkronjën (b), pika1, më sipër, edhe **për mos inventarizimin dhe arkivimin pranë zyrës së arkivit**, të dokumentacionit që përmbanin 165 Dosjet e përfituesve të kredisë, të cilët ishin miratuar në Këshillin Bashkiak, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” Rregullorja “Për punën dhe dokumentet administrative në organet shtetërore dhe jo shtetërore”, për “Normat tekniko-profesionale-metodologjike të shërbimit arkivor” dhe Lista Tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK),miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

3. K.Q., specialiste e kontabilitetit, *pasi nuk ka rakorduar me:*

-Degën e tatim taksave të bashkisë dhe me 5 arkëtalet e Rajoneve, në lidhje me realizimin e taksave të popullatës, sipas llojeve dhe numrin e familjeve që paguajnë taksat vendore.

-Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik dhe Policinë Bashkiake, për numrin dhe vlerën e gjobave të arkëtuara pranë Degëve të Bankave.

-Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë

-Me drejtoritë e tjera të cilët rigjenerojnë dhe derdhin të ardhura nëpërmjet Bankës apo arkës dhe konkretisht: Të ardhurat nga therjet,objektet me qira, ndërmarrja e Shërbimeve, drejtoria e Transporteve etj.

-Nuk janë regjistruar veprimet për të ardhurat në kompjuter dhe në librat përkatëse.

-Nuk janë hartuar dhe mungojnë artikujt kontabël të ditarit të veprimeve më të ardhurat e bankës dhe nuk i janë paraqitur për kontabilizim, ato sektorit të financës në fund të periudhave 4 mujore dhe vjetore.

Mos mbajtja e dokumentacionit të mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, ”Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2 shkronja (c),”Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”.

- Nuk ka përmbushur edhe detyrat e përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Vlorë “Për organizimin, funksionimin e detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë”, miratuar me VKB nr. 40, datë 17.10.2008, ndryshuar me nr. 11 datë 29.03.2012.” neni 55, -Detyrat e specialistit kontabilitetit analitik të të ardhurave.

c) Mbështetur në nenet 144, 145 dhe 146, të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, ligjit për “Nëpunësin Civil” dhe kontratës individuale të punës, neni 9, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ” i cili përcakton se: “Në rast se gjobat dhe detyrimet e tjera, të vendosura nga vendimi për kundërvajtjen administrative, nuk paguhen për mosveprim të punonjësit të organit administrativ, i cili ka miratuar vendimin përkatës dhe detyrimin që të kërkojë arkëtimin e shumave, apo për shkak se punonjësi nuk nis procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ, atëherë ndaj tij fillojnë procedurat e largimit nga puna”, i rekomandojmë titullarit të Njesisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Vlorë, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore “Zgjidhje e kontratës së punësimit”, për:

1. B.K., Kryeinspektor i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Vlorë, për 1 vit e gjysmë, emëruar me urdhrin nr. 41 datë 18.06.2012 për periudhën nga data 18.06.2012 e në vazhdim.

2. A.Sh., jurist i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Vlorë, për një periudhë 5 vjeçare emëruar me urdhrin nr. 52, datë 09.04.2008 e në vazhdim, pasi:

I. Nga mos kontrolli i territorit kanë lejuar 11 subjekte ndërtuese të cilët edhe pse nuk kishin të zbardhur lejen e ndërtimit, kanë filluar e mbaruar objektet, si, Godina- pallate 7-10 katesh, pa u penguar nga INUV-ja, ku përveç konsumimit të veprës penale të ndërtimit pa lejë, parashikuar në nenin 199/a të Kodit Penal, Ndërtimi i paligjshëm, 4 subjektet nuk kanë derdhur në Bashkinë Vlorë, taksën e ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 **“Për urbanistikën”**, të ndryshuar dhe VKB Vlorë nr. 62, datë 26.11.2009 **“Për taksat dhe tarifatat vendore”**, të ndryshuar, duke shkaktuar mungesë të ardhurave në vlerën prej 30,506,922 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet në 11 Rastet e mëposhtme janë në kundërshtim me;

1 -pikën c të nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 **“Për inspektimin e ndërtimit”** ku përcaktohet se: *Inspektorati vendos gjykon sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;*

2-pikën 8 të VKM. nr. 862 datë 05.12.2007 **“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor”**, ku përcaktohet se: *Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë, si dhe përgatitet kallëzim penal për kundërvajtjen.*

3-pikën 8/b-iii, të nenit 82 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 **“Për planifikimin e territorit”**, Kryerja e punimeve pa leje: me pasoja në krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor dënohet me gjobë nga 400,000 lekë deri në 60 për qind të vlerës totale të punimeve të kryera pa leje.

Realizimi i këtyre ndërtimeve, pa leje të zbardhur nga ana e KRRT-së, Bashkia Vlorë, tregon se INUV, nuk ka funksionuar në përputhje me nenin neni 81/1 të ligjit nr. 10119 datë 23.4.2009 **“Për planifikimin e territorit.”**, ku përcaktohet se: *Inspektimi ka për mision bazë parandalimin e zhvillimeve të paautorizuara në territor apo të shkeljeve të kushteve të lejeve, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji.*

II- Nga INUV Bashkia Vlorë, nuk janë hartuar plane pune mujore të miratuar nga kryeinspektori, për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të Bashkisë Vlorë. Kjo mënyrë organizimi bie ndesh me VKM nr. 862, datë 5.12.2007 **“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor.” dhe konkretisht pikën 1/ii .**

III- Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se nga 280 raste procesverbale kontrolli dhe konstatimi, të grupuara sipas natyrës së shkeljeve paraqiten:

-102 prej tyre janë banesa, shtesa kati, shtesa pallati pa leje ndërtimi, (11 nga këto janë subjekte që kanë shkelur lejen e miratuar.)

-65 prej tyre janë për subjekte ndërtuese të cilave u mungon njoftimi pranë INUV, mungon oponenca teknike, kanë mungesa në dokumentacionin tekniko ligjor në kantier etj.

Bazuar në mangësitë e përshkruara nga inspektorët në procesverbalet e kontrollit e konstatimi gjatë kontrollit në kantiere ndërtimi, Vendime për pezullim punimesh duhej që të merreshin 69 Vendime për pezullimin e punimeve të ndërtimit, në fakt janë vendosur 54 Vendime për pezullimin e punimeve.

-Për 211 objektet e tjera të konstatuara, si ndërtime të paligjshme duhej vepruar në bazë të dispozitave ligjore për ndërtimet pa leje, por nga auditimi rezultoi se:

a. Janë hartuar 45 procesverbale për ndërtime pa leje, për persona të paidentifikuar.

b-90 objekte janë Banesa, shtesa kati, shtesa pallati pa leje ndërtimi, të konstatuara nga procesverbalet e kontrollit, për të cilat vetëm në 39 raste janë vendosur gjoba, për 51 raste të ndërtimeve pa leje të konstatuara e evidentuara nga procesverbalet e kontrollit e konstatimi, nga INUV-ja, nuk janë vendosur gjoba dhe nuk është bërë kallëzim penal, duke vepruar në kundërshtim me:

-ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit.”, ku Inspektorati Ndërtimor Urbanistik, sipas nenit 5 shkronjat:

c) vendos gjoba sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës;

dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

Nga 176 vendime për prishje janë ekzekutuar 71 vendime për prishje objekti pa leje, -ndërkohë 174 vendimet e prishjes nuk janë shoqëruar edhe me vendime për dënim me gjobë e kallëzim penal, duke mos zbatuar pikën 8 të VKM nr. 862 datë 05.12.2007.

IV. Për periudhën 18.06.2012-31.12.2013, nga INUV Bashkisë Vlorë, janë vendosur 131 gjoba në vlerën 51.352.000 lekë. Janë anulur 4 vendime për dënimin me gjobë: me arsyetimin se Fletë gjobat nr. 175,176,177 dhe 178, janë përdorur për vendime të tjera për dënimin me gjobë. Janë përsëritur vetëm tre vendime për dënimin me gjobë.

Proces verbalet e konstatimit dhe vendimet e gjobave të vendosura nga ana e INUV, për periudhën 18.06.201-31.12.2013, me kryeinspektor z. B.K., ndaj 131 kundërvajtësve në vlerën 51.352.000 lekë, (rast unikal nuk është arkëtuar asnjë gjobë), duke u shtuar kamat vonesat 2% në ditë 1.020.000 lekë për 1 muaj -30.020.000 lekë, vlera për tu paguar arin në shumën 81.952.000 lekë, për të cilat nuk kanë nisur procedurat për arkëtimin e tyre. Mos vjelja e 131 gjobave në vlerën 51.352.000 lekë, është në kundërshtim me: ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, ekzekutimi i vendimeve për gjobat duhej të kërkohej në rrugë gjyqësore, bazuar në nenin 16; ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në nenet 9, 22 dhe 30 të cilat në mënyrë eksplicite përcaktojnë:

4. Kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht, nga:

a)-kryetari i bashkisë apo komunës.

b)-titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtje administrative.

z. A.Sh. me detyrë jurist, në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik, pasi nuk ka zbatuar procedurat e nevojshme ligjore, për arkëtimin e 184 gjobave të vendosura për periudhën 2011-2012-2013 nga INUV- Vlorë, në vlerën prej 61,682,000 lekë, pa llogaritur kamat vonesat 2% në ditë (dhe mos u arkëtuar asnjë gjobë,) duke shkelur: ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, ku bazuar në nenin 16, ekzekutimi i vendimeve për gjobat duhej të kërkohej në rrugë gjyqësore; ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” në nenet 9, 22 dhe 30 të cilat në mënyrë eksplicite përcaktojnë:

4. Kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht, nga:

a)-kryetari i bashkisë apo komunës.

b)-titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtje administrative.

Vetë fakti që nga grupi i auditimit të KLSH u konstatua se procedurat ligjore për arkëtimin e 184 gjobave në vlerën 61,682,200 lekë për periudhën 3 vjeçare(2011-2013), nuk janë kryer(ku një pjesë e tyre janë në limitet e kufirit kohor prej 2 vjetësh të parashkrimit), për shkak të mos njohjes së ligjit nga Kryeinspektori i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Vlorë z. B.K. dhe veçanërisht nga z. A.SH., jurist i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik të Bashkisë Vlorë. Vendimet e gjobave janë trajtuar nga këta dy punonjës si padi civile, duke menduar se duhej të paguhej taksë në gjykatë për secilën padi në vlerën prej 12,000 lekë, sipas udhëzimit nr. 13, datë 12.02.2009 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në veprimet e administratës gjyqësore, Ministrisë Drejtësisë , Prokurorisë, Noterët dhe ZVRPP”, pra INUV i Bashkisë, pretendon se nuk ka filluar procedurat ligjore për arkëtimin e gjobave, pasi nuk siguroheshin fondet për to.

Ndërkohë, që për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative, organet e administratës shtetërore përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e tarifave, sipas ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” pika 1 e nenit 43- Përjashtimi nga detyrimet, ku në mënyrë eksplicite shkruhet se: Për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative, organet e administratës shtetërore përjashtohen nga detyrimi për parapagimin e tarifave gjyqësore dhe për veprimet e shërbimit, që kryhen nga administrata gjyqësore dhe përmbaruesi gjyqësor.

2. Shpenzimet për vënien në ekzekutim të vendimeve për kundërvajtjet administrative përballohen nga kundërvajtësi.

Kjo shkelje pranohet nga INUV, pasi Bashkia Vlorë me shkresën nr. 4066, datë 23.12.2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit për aktet administrative të INUV Bashkia Vlorë, ku pas kësaj, në harkun kohor prej 3 muajsh deri në muajin mars 2014, nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Vlorë, u kthyen në tituj ekzekutivë 47 vendime gjobe në vlerën prej 18,650,000 lekë (ose 30% e tyre)

Gjobat e vendosura për secilin kundërvajtës ndodhen në Aneksin nr. 23 bashkëlidhur, kurse në mënyrë të përmbledhur për periudhën 3 vjeçare 2011-2012-2013 nga INUV- Vlorë, paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Gjithsej 01.01.2011-31.12.2013 Nga të cilat:	Në numër		Në lekë	
		184	Në %	61,682,000	Në %
a	Janë dërguar për Kallëzim Penal	23	12	7,600,000	12
b	Anuluar nga Kryetari i Bashkisë	4		2,000,000	0.3
c	Anuluar për gabime nga vetë INUV	5		1,400,000	0,2
d	Janë dërguar në Gjykatë dhe janë nxjerrë urdhrat ekzekutive, pas datës fillimit të auditimit 16.12.2013-Mars 2014	47	26	18,650,000	30
e	Pa filluar procedurat e arkëtimit	105	57	32,032,000	60

d) Mbështetur në nenet 144, 145 dhe 146, të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, ligjit për “Nëpunësin Civil” dhe kontratës individuale të punës, neni 9 i rekomandojmë titullarit të Njesisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Vlorë, të vlerësojë veprimtarinë administrative në përmbushjen e detyrave të caktuara, për 7 anëtarët e

KRRT-së, të cilët aktualisht janë në marrëdhënie pune me Bashkinë Vlorë, dhe të marrë masa disiplinore për personat e mëposhtëm:

1. **D.H.**, ish-Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Sekretar i KRRT-së, aktualisht specialist në këtë Drejtori.
2. **R.A.**, anëtare e KRRT-së, aktualisht në detyrën e administrimit të regjistrit-G.I.S.
3. **A.F.**, anëtare e këshillit teknik, Sekretare e Sekretarisë Teknike, aktualisht inxhinieri ndërtimi në arkivën elektronike (regjistrin elektronik) drejtorinë e Planifikimit Territorit.
4. **M.T.**, anëtare e Këshillit Teknik, aktualisht specialiste në drejtorinë e Planifikimit Territorit.
5. **E.D.**, anëtare e Këshillit Teknik, aktualisht inxhinieri ndërtimi në arkivën elektronike (regjistrin elektronik) në drejtorinë e Planifikimit Territorit.
6. **A.C.**, anëtar i KRRT-së, Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe në cilësinë e antares së komisionit të strehimit.
7. **A.M.**, anëtar i KRRT-së, aktualisht në detyrën e N/Kryetarit të Bashkisë dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit të strehimit.

Për shkeljet e kryera në:

1- Miratimin e vendimit nr. 2/29 dhe nr. 2/30, datë 28.09.2011 subjekti ndërtues “R...” sh.p.k, duke miratuar ***në brezin e parë të ndërtimit 2 kate më shumë se*** vendimi i KRRTSH-së nr. 1, datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe vendimin nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”, ku përcaktohet: “Të respektohet lartësia e kateve 6 kat maksimumi (nga Akademia e Marinës deri tek 7 pallatet) për një brez 30-40 m nga vija e kuqe e ndërtimit...me konfiguracionin që të mos pengojnë leximin e detit nga godinat e brezit të dytë...dhe 6 deri në 8 kate në brezat e tjerë duke i kombinuar sipas lartësisë” dhe pikën pika 66, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

2- Miratimin e vendimit nr. 2/31 dhe nr. 2/32, datë 28.09.2011 subjekti ndërtues “D...” sh.p.k, duke miratuar ***në brezin e parë të ndërtimit 2 kate më shumë se*** vendimi i KRRTSH-së nr. 1, datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe vendimin nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”, ku përcaktohet: “Të respektohet lartësia e kateve 6 kat maksimumi (nga Akademia e Marinës deri tek 7 pallatet) për një brez 30-40 m nga vija e kuqe e ndërtimit...me konfiguracionin që të mos pengojnë leximin e detit nga godinat e brezit të dytë...dhe 6 deri në 8 kate në brezat e tjerë duke i kombinuar sipas lartësisë” dhe pikën pika 66, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

3- Miratimin e vendimit nr. 2/33 dhe nr. 2/34, datë 28.09.2011 subjekti ndërtues “A...” sh.p.k, duke miratuar ***në brezin e parë të ndërtimit 2 kate më shumë se*** vendimi i KRRTSH-së nr. 1, datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe vendimin nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”, ku përcaktohet: “Të respektohet lartësia e kateve 6 kat maksimumi (nga Akademia e Marinës deri tek 7 pallatet) për një brez 30-40 m nga vija e kuqe e ndërtimit...me konfiguracionin që të mos pengojnë leximin e detit nga godinat e brezit të dytë...dhe 6 deri në 8 kate në brezat e tjerë duke i

kombinuar sipas lartësisë” dhe pikën pika 66, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

4- Miratimin e vendimit nr. 2/109 dhe nr. 2/110, datë 28.09.2011, subjekti ndërtues “A...” sh.p.k duke miratuar shtesë kati mbi katin e 8 pasi objekti ndodhet në brezin e parë të segmentit Skelë Ujë i Ftohtë që bënë pjesë në **vijën e kuqe të ndërtimit**, në kundërshtim me vendimin e KRRTRSH-së nr. 1, datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe vendimin nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”, ku përcaktohet: ”Të respektohet lartësia e kateve 6 kat maksimumi (nga Akademia e Marinës deri tek 7 pallatet) për një brez 30-40 m nga vija e kuqe e ndërtimit...me kofiguracionin që të mos pengojnë leximin e detit nga godinat e brezit të dytë...dhe 6 deri në 8 kate në brezat e tjerë duke i kombinuar sipas lartësisë” dhe pikën pika 66, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

5- Miratimin e vendimit nr. 2/325, datë 28.09.2011, subjekti ndërtues “A...” sh.p.k, duke miratuar **8 kate më shumë**, në kundërshtim me Vendimin e KRRTRSH-së nr. 1, datë 23.06.2004 “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës” dhe Vendimin e KRRTRSH-së nr. 2, datë 18.12.2004 “Për miratimin e rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Vlorës”.

6- Miratimin e vendimit nr. 2/289, datë 28.09.2011, subjekti ndërtues “R...” dhe “A...” sh.p.k me sipërfaqe sheshi **5,300 m²**, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me ligjin nr. 9743, datë 28.05.2007 përcaktohet: ”Leja e ndërtimit i jepet kërkuesit të saj sipas *formularit nr. 4*, pjesë e këtij ligji.... Për rastet kur sipërfaqja e sheshit është mbi 0.5 hektar, leja e ndërtimit plotësohet nga sekretaria teknike e KRRT-së, pasi është miratuar leja në KRRTRSH...”

7- Miratimin e vendimit nr. 2/338, datë 28.09.2011 subjekti ndërtues “C...dhe Albania I...” sh.p.k me sipërfaqe sheshi **10,550 m²**, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, ndryshkur me ligjin nr. 9743, datë 28.05.2007 përcaktohet: ”Leja e ndërtimit i jepet kërkuesit të saj sipas *formularit nr. 4*, pjesë e këtij ligji.... Për rastet kur sipërfaqja e sheshit është mbi 0.5 hektar, leja e ndërtimit plotësohet nga sekretaria teknike e KRRT-së, pasi është miratuar leja në KRRTRSH...”.

8- Në zbardhjen e vendimit nr. 2/31 dhe 2/32 datë 28.09.2011, për godinë banimi dhe shërbimi 7-8-9 kate me 1 kat nëntokë, **me 1 kate më shumë** se procesverbali i mbledhjes së KRRT-së datë 28.09.2011, në lagjen “Ujë i Ftohtë” në pronësi të familjes Sh..., R..., me subjekt ndërtues “D...”, veprim në kundërshtim me pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“, neni 253 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, të ndryshuar, dhe nenin 45, të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar.

9- Në zbardhjen e vendimit nr. 2/241 dhe nr. 2/242 datë 28.09.2011, për godinë banimi dhe shërbimi 7-8-9 kate me 1 kat nëntokë, e ka bërë **me 1 kat më shumë** se procesverbali i mbledhjes së KRRT-së datë 28.09.2011, ku është miratuar godinë banimi dhe shërbimi 8 kat me 1 kat nëntokë në pronësi të L.D., F.H. dhe F.H. me subjekt ndërtues “B...”, në lagjen

“24 Maji”, veprim në kundërshtim me pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“, neni 253 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 45, të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar.

10- Në zbardhjen e vendimit nr. 2/366 datë 28.09.2011, zgjatjen e afatit për leje ndërtimi për objekt banimi 8-9 kate me dyqane me 1-kat nëntokë në lagjen “10 Korriku”, e ka bërë **me 3 kate më shumë** se procesverbali i mbledhjes së KRRT-së datë 28.09.2011, për objekt 12 kat me 1 kat nëntokë në pronësi të familjes K..., me subjekt ndërtues “R... Konstruksion” në lagjen “10 Korriku”, veprim në kundërshtim me pikën 4 të nenit 16 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike“, neni 253 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 45, të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar.

11. Nga Drejtoria e Planifikimit Urban nuk janë respektuar distancat minimale të objektit, në Veri dhe Jug të objektit, nga subjekti **ndërtues “E...” sh.p.k.**, me 9 kate në lagjen “Uji i Ftohte”, duke vendosur në kufirin maksimal të pronës, ndërsa objekti në të dy anët është me dritare dhe ballkone. Vendosja e objektit në kufirin maksimal të pronës, ka bërë që të mos respektohet distanca ndërmjet banesave dhe gjendja e fqinjësisë në krijimin e hapësirave të nevojshme funksionale ndërmjet ndërtimeve, në kundërshtim me pikën 118 dhe 120, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe KRRT-ja, miratimin e ndërtimit të objektit 6-7-8 kat + papafingo me 1 kat nëntokë në Veri dhe Jug, e ka vendosur në pikën zero të kufirit të pronës. Dalja e objektit është miratuar mbi pasurinë nr. 6/66, pasuri e cila i përket një pronari të pavërtetuar apo shtetit, duke përfshirë edhe një pasuri pa numër pasurie që ndodhet në kufirin verior të saj, duke mos respektuar kufirin e ndarjes së pronësisë, në kundërshtim me pikën 66, 118, shkronjën “d” të pikës 120, të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

Përveç shkeljeve në miratimin e lejeve të ndërtimit në cilësinë e antarit të KRRT edhe në cilësinë e antarit dhe kryetarit të komisionit të strehimit respektivisht 2 personat e cituar më sipër **znj. A.C.**, anëtare e KRRT-së, Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe në cilësinë e antares së komisionit të strehimit dhe trajtuara më hollësisht tek shkronja (b), pika 1 më sipër ku është folur për masën e dhënë ndaj **z. A.M.**, anëtar i KRRT-së, aktualisht në detyrën e N/Kryetarit të Bashkisë dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit të strehimit.

d) Mbështetur në **nenet 144,145 dhe 146, të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”** i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 9 shkronjat (a,b,ç,d), të nenit 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe Kontratat individuale të punës, neni 9 shkronja (d) i rekomandojmë titullarit të Njesisë Publike, Kryetarit të Bashkisë Vlorë, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje më paralajmërim” për 2 mbikëqyrëset e shërbimit të pastrimit si më poshtë:

1. V.Ç., inxhinieri hidroteknike në drejtorinë e Infrastrukturës dhe Zbatimit Projekteve, për periudhën 4 mujore shtator 2013 e në vazhdim e ngarkuar me detyrën e mbikëqyrës së pastrimit **për shkeljet e mëposhtme;**

- nga mos kontrolli i punimeve në shërbimin e pastrimit ka lejuar të situacionohen dhe likujdohen punime të pakryera me dëm ekonomik në vlerën prej **44,499,901 lekë**, në objektin “*Shërbimi i Pastrimit Urban*”, sipas kontratës datë 02.02.2009, në moszbatim të neneve 21.2; 21.5; 36.4.5; 36.2.6/a; 36.4.6 të kontratës.

2. L.Z., ish-mbikëqyrëse e pastrimit specialiste e mesme e përgjithshme, aktualisht inspektore infrastrukture në drejtorinë e Infrastrukturës dhe Zbatimit Projekteve, **për shkeljet e mëposhtme:**

- nga mos kontrolli i punimeve në shërbimin e pastrimit ka lejuar të situacionohen dhe likujdohen punime të pakryera me dëm ekonomik në vlerën prej **44,499,901 lekë**, në objektin “*Shërbimi i Pastrimit Urban*”, sipas kontratës datë 02.02.2009, në moszbatim të neneve 21.2; 21.5; 36.4.5; 36.2.6/a; 36.4.6 të kontratës.

E. MASA ADMINISTRATIVE:

a. Për Agjencinë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në 3 proces verbalet nr. 29,30 dhe 31, datë 12.03.2014, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, **i rekomandojmë Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për 3 anëtarët e Komisionit Vlerësimit të Ofertave si më poshtë:**

1. Z.E.L. me detyrë ish N/Kryetar i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit **të ofertave në 20 tendera**, respektivisht;

a-në 14 tendera të zhvilluar në vitin 2011 me objekt, “Sistemim i bllokut Bashki – Rruga Demokracia”, “Sistemim i bulevardit Vlorë-Skelë”, “Sistemim asfaltim blloku nr.1 ne lagjen “Isa Boletini”, Rajoni nr.2 (zona nga rruga Mustafa Bello – QTS – Rruga e Unazës – rruga Sadik Zotaj”, “Rikonstruksion i rrugës “Dervish Hekali & Enriko Veizi”, “Rikonstruksion i rrugës “Vasil Talo”, “Sistemim i rrugëve “Dëshmoret” “Kastriot Gjini” - “Benjamin Kruta” - “Abedin Nepravishta”, “Sistemim asfaltim i bllokut te pallatet e Gorishtit”, “Rikonstruksion i rrugës “Zahir Pajaziti” dhe “Bilal Golemi”, “Sistemim zgjerim i trotuarit dhe ambienteve të gjelberta në rrugën “Çameria” dhe “Murat Tërbaçi”, “Rikonstruksion i rrugës “Petro Marko”, “Rikonstruksion i shkollës “Ismail Qemali”, “Rikonstuksion shkolla “Musa Çakëri”, “Rrugë në lagjen Velaj, në lagjen “Uji I Ftohtë” deri tek shkolla teknologjike”, “Sistemim asfaltim i rrugës “Pavlo Flloko”, te 7 pallatet”, pasi është shpallur fitues oferta

që nuk plotëson kriterin për kualifikim, gjë që ka sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në shumën prej 1,927,844 lekë.

b- në 5 tendera të zhvilluar në vitin 2012 me objekt: "Rikonceptim i sheshit Pavaresia, Vlore (faza I)", "Rikonceptim i sheshit Pavaresia (faza II) + segmenti i shetitores", "Rikonceptim i sheshit te Flamurit", "Rikonstruksion i shkolles "Muço Delo", "Sistemimi dhe gjelbërimi i bllokut të banimit tek pallatet e Gorishtit dhe lulishtja në hyrje të qytetit".

2. Z. A.M. me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Vlorë në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në 21 tendera, respektivisht:

a-në 14 tendera të zhvilluar në vitin 2011 me objekt, "Sistemim i bllokut Bashki – Rruga Demokracia", "Sistemim i bulevardit Vlorë-Skelë", "Sistemim asfaltim blloku nr.1 ne lagjen "Isa Boletini", Rajoni nr.2 (zona nga rruga Mustafa Bello – QTS – Rruga e Unazës – rruga Sadik Zotaj", "Rikonstruksion i rrugës "Dervish Hekali & Enriko Veizi", "Rikonstruksion i rrugës "Vasil Talo", "Sistemim i rrugëve "Dëshmoret" "Kastriot Gjini" -"Benjamin Kruta" - "Abedin Nepravishta", "Sistemim asfaltim i bllokut te pallatet e Gorishtit", "Rikonstruksion i rrugës "Zahir Pajaziti" dhe "Bilal Golemi", "Sistemim zgjerim i trotuarit dhe ambienteve të gjelberta në rrugën "Çameria" dhe "Murat Tërbaçi", "Rikonstruksion i rrugës "Petro Marko", "Rikonstruksion i shkollës "Ismail Qemali", "Rikonstruksion shkolla "Musa Çakëri", "Rrugë në lagjen Velaj, në lagjen "Uji I Ftohtë" deri tek shkolla teknologjike", "Sistemim asfaltim i rrugës "Pavlo Flloko", te 7 pallatet", pasi është shpallur fitues oferta që nuk plotëson kriterin për kualifikim, gjë që ka sjellë përdorimin pa efektivitet të fondeve buxhetore në shumën **prej 1,927,844 lekë**.

b-në 5 tendera të zhvilluar në vitin 2012 me objekt: "Rikonceptim i sheshit Pavaresia, Vlore (faza I)", "Rikonceptim i sheshit Pavaresia (faza II) + segmenti i shetitores", "Rikonceptim i sheshit te Flamurit", "Rikonstruksion i shkolles "Muço Delo", "Sistemimi dhe gjelbërimi i bllokut të banimit tek pallatet e Gorishtit dhe lulishtja në hyrje të qytetit"

c- në 1 tender të zhvilluar në vitin 2013 me objekt "Sistemimi i trotuareve në qytet", në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Z. I.B. me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Vlorë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave në 4 tendera, respektivisht në 2 tendera të zhvilluar në vitin 2012 me objekt "Blerje makina për policinë bashkiake", "Blerje materiale elektrike" dhe 2 tendera të zhvilluar në vitin 2011 me të njëjtin objekt "Blerje materiale elektrike" pasi është shpallur fitues oferta që nuk plotëson kriterin për kualifikim.

b.Për Inspektoriatin Ndërtimor Urbanistik Bashkia Vlorë.

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7; pikat, 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar; pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të kreut II-të dhe pikat 4, 5 të kreut III-të, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", **i propozohet:** Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik, pranë Bashkisë Vlorë, që të vlerësojë dhe të marrë masa administrative me gjobë për **mbikqyrësat e punimeve si më poshtë:**

1. N.M., në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve, me licencë MK 0992/2, “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën 7,051,627 lekë, sipas preventivit dhe kontratës datë 10.05.2011, në objektin: “Sistemim i bulevardit Vlorë – Skelë” dhe 409,850 lekë, sipas preventivit dhe kontratës datë 13.01.2011, në objektin: “Rruga “Gjergj Araniti” në veri të kombinatit”.

2.V.G., me cilësinë e përfaqësueses së shoqërisë “Palma Konstruksion”, në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve, me licencë 0899/9, “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën 431,671 lekë, sipas preventivit dhe kontratës datë 03.08.2012, në objektin: “Rikonceptimi i Sheshit të Flamurit” dhe 10,102,250 lekë, sipas preventivit dhe kontratës datë 02.07.2012 “Rikonceptimi i Sheshit Pavarësia (faza e II) + segmenti i parë i shëtitorës”.

3. L.Dh., në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve, me licencë MK 0714/1, “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën 4,028,080 lekë, sipas preventivit dhe kontratës datë 23.03.2009, në objektin: “Sistemim i rrugës Topana – Kuzum Baba”.

4. I.Ç., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK MK 1761, “Për mbikëqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi”, pasi nga mos kontrolli ka rezultuar se janë raportuar punime të pakryera në vlerën 957,620 lekë, sipas preventivit dhe kontratës datë 16.05.2011, në objektin: “Sistemim asfaltim blloku Nr. 1, lagjja “Isa Boletini”, Bashkia Vlorë”.

b. Për Ministrinë e Drejtësisë:

Për shkeljet e konstatuara në dokumentet shkresore të hartuara, pranuar dhe noterizuara, konkretisht 5 kontratat bazuar në nenin 8 shkronja “ç” të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë” i ndryshuar, ***i rekomandojmë, Ministrit të Drejtësisë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave përkatëse në raport me shkeljet e konstatuara, për 3 noterët publikë si më poshtë:***

1. **E.K.**, për kontratën nr. 2946 Rep dhe nr.154 Kol datë **4 Qershor 2002**, me palët kontraktuese METE dhe Shoqëria “I...” shpk., me seli në Tiranë,

2. E.S., për noterizimin e 2 kontratave të mëposhtme:

- për Aneks Kontratën nr. 4917 rep nr. 1900 kol, **datë 1 Nëntor 2004** me palët kontraktuese METE dhe shoqërisë “I...” shpk, të cilësuar si “Qiramarrës”.

-për Aneks Kontratën, nr. 3873 Rep. nr. 2079 kol **datë 1 Korrik 2005.** me palët kontraktuese METE dhe shoqërisë “I...” shpk, të cilësuar si “Qiramarrës” për ndryshime në kontratën fillestare nr. 2946 Rep. nr. 154 Kol. datë 4 Qershor 2002, nga, ku neni 3 i kontratës riformulohet se ...”Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet duke filluar nga data e nënshkrimit të saj” **duke zgjatur afatin e vlefshmërisë së kontratës nga 10 vjet në 20 vjet.**

3. Majlinda Lleshi për noterizimin e 2 kontratave të mëposhtme:

- për Aneks Kontratën, nr. 3584 Rep. 636 kol. **datë 5 Qershor 2006** hartuar nga Noter Majlinda Lleshi me palët kontraktuese METE në cilësinë e Qiradhënësit, dhe Shoqëria "I..." dhe "I... 1" shpk., me seli në Tiranë në Vlorë, për ndarjen e Shoqërisë "I..." shpk Tiranë në dy shoqëri:

- për Aneks Kontratë .nr. 3583 Rep. 954 kol, **datë 3 Korrik 2013.** me palët kontraktuese METE përfaqësuar dhe Shoqëria "I... 1" shpk., me seli në Vlorë, përfaqësuar nga znj. N.L. në cilësinë e Qiramarrësit.

Në hartimin dhe noterizimin e 5 kontratave, u konstatuan shkeljet e përbashkëta ligjore si më poshtë:

1. Për pasuritë janë noterizuar kontratat e qirasë pa ju transferuar me VKM dhe pa u regjistruar në emër të Bashkisë Vlorë, **pra, pa i pasur ato në pronësi në kundërshtim me nenin 193, 195 dhe 678 të Kodit Civil, etj.,** (madje nuk figurojnë as në listat paraprake), të miratuar me VKM nr. 639, datë 29.9.2007 "*Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Bashkinë Vlorë, të Qarkut Vlorë*" dhe VKM nr.1643, datë 17.12.2008 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vlorë, të Qarkut Vlorë*".

2. Pasuritë për dhënien **me qira** janë noterizuar **pa i patur në pronësi, e në kundërshtim me nenin 193, 195 dhe 678 të Kodit Civil, etj.,** Bashkia Vlorë , duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*", neni 18 -**Dokumentacioni i transferimit, ku përcaktohet se:** *Të gjitha pronat, të cilat u kalohen në pronësi njërive të qeverisjes vendore sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Po kështu do të regjistrohen në kartelën e pasurisë së paluajtshme edhe kushtet dhe kufizimet e vendosura sipas këtij ligji.*

Në këto kushte, për shkak se prona objekt i këtyre kontratave nuk është në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe as të METE, objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk është në përputhje me nenin 678, të **Kodit Civil, ku përcaktohet se:** "*Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet*".

Mos përmbushja e këtij detyrimi nga Bashkia Vlorë dhe mungesa e kompetencës ligjore për të vepruar dhe konkretisht për të kryer marrëdhënie kontraktuale e bën këtë marrëdhënie me produkt kontratë njëherësh absolutisht të pavlefshme.

3. Hartimi dhe noterizimi i kontratave është kryer pa ju përmbajtur detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "*Për Noterinë*", i ndryshuar, neni 54, Procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme, **ku përcaktohet:** Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, **pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm.** Për këtë qëllim pala i paraqet noterit dokumentet e pronësisë dhe noteri, me pëlqimin e tij, verifikon gjendjen juridike të pronësisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

Noteri duhet të shënojë në aktin noterial për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme verifikimin e bërë dhe t'i bashkëlidhë rezultatin e verifikimit. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë.

b.Masa Disiplinore për Ndërmarrjen e Shërbimeve, në vartësi të Bashkisë Vlorë

A. MASA DISIPLINORE

*Mbështetur në nenin 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Për Kodin e Punës", ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, në kontratën individuale të punës, në rregulloren e organizimit, funksionimit, detyrave dhe kompetencave të administratës së Bashkisë Vlorë si dhe nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" kërkojmë që drejtori i ndërmarrjes së Shërbimeve, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **"Vërejtje me paralajmërim" për 6 punonjësit e mëposhtëm:***

1.V.D., me detyrë magazinierë pasi ka hartuar fletë daljet e magazinës, në fund të muajit, në një fletë përmbledhëse për të gjithë personat që kanë tërhequr karburant, sipas urdhër dorëzimeve, ku është përcaktuar vetëm emri i personit të autorizuar për tërheqjen e karburantit pa përcaktuar llojin, tipin e mjetit dhe targën pa vepruar në zbatim të plotë me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pikat 34, 35 germa "a" dhe "b", 37 dhe 39.

2.J.H., me detyrë drejtuese në sektorin e plazhit, ngarkuar me ndjekjen e konsumit të karburantit pasi

-ka pranuar fletët e udhëtimit, të nënshkruara të paraqesin punën e kryer "në orë" ose "rrugë" pa përcaktuar volumet e punës në njësi matëse të sakta në "ton" ose në "m³" si dhe pa u shoqëruar me preventiv apo situacion të punimeve të kryera sipas çdo objekti.

-Kilometrat janë shënuar më laps dhe nuk pasqyrohen në të gjitha rastet e lëvizjes së kamionëve.

-në fletët e udhëtimit nuk janë shënuar targat apo tipi i mjetit si dhe ka raste që nuk janë nënshkruar nga personat përgjegjës për punën e kryer,

3. H.O., me detyrë përgjegjës i degës Ekonomi Financë pasi:

- Nuk janë evidentuar dhe paraqitur të plota në regjistra dhe në inventar në zbatim të plotë me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kreu III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" pikat 26, 30 germa "a" "b" "c" dhe pika 36.

-ka lejuar të hartohen fletë daljet e magazinës për karburantin, në fund të muajit, në një fletë përmbledhëse për të gjithë personat që kanë tërhequr karburant, sipas urdhër dorëzimeve, ku është përcaktuar vetëm emri i personit të autorizuar për tërheqjen e karburantit pa përcaktuar llojin, tipin e mjetit dhe targën pa vepruar në zbatim të plotë me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pikat 34, 35 germa "a" dhe "b", 37 dhe 39.

-nuk ka ushtruar kontrole periodike për dokumentimin dhe administrimin e karburantit, krahasuar me fletët e udhëtimit të administruara.

4. S.J., me detyrë llogaritar i njësisë pasi

-ka lejuar të hartohen, pranuar dhe kontabilizuar fletë daljet e magazinës për karburantin, në fund të muajit, në një fletë përmbledhëse për të gjithë personat që kanë tërhequr karburant, sipas urdhër dorëzimeve, ku është përcaktuar vetëm emri i personit të autorizuar për tërheqjen e karburantit pa përcaktuar llojin, tipin e mjetit dhe targën pa vepruar në zbatim të plotë me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pikat 34, 35 germa "a" dhe "b", 37 dhe 39.

5. N.Ç., me detyrë përgjegjës i sektorit hidrofor oficinë, makineri,transport.

6. E.H., me detyrë përgjegjës i degës teknike, pasi:

-nuk kanë përcaktuar volumet e punës në "ton" dhe "m3" por në "rrugë" në të gjithë rastet e transportit të dherave gjatë pastrimit të linjave dhe pastrimit të pusëve të ujërave të zeza dhe të bardha, sipas kriterëve në zbatim të plotë UKM nr. 2, datë 8.5.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit" dhe neni 3 dhe 5, i ligjit nr. 8402, datë 17.9.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

-nuk janë përcaktuar me emërtime të sakta, gjatë matjeve të konsumit të karburantit, distancat e përshkuara të rrugës, në udhëtim brenda dhe jashtë qytetit si dhe të volumeve të punës së kryer bazuar në nenet 11 dhe 12 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit zbatues" të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"

G. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL

Për 10 ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre, por duhet të njoftohet DAP lidhur me rekomandimin që KLSH do të kishte dhënë nëse do të ishin ende në marrëdhënie pune.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte "Largim nga shërbimi civil" apo "Zgjidhje e kontratës së punësimit" **përkatësisht;**

1.**J.B.**, me detyrë ish-juriste larguar me datë 07.06.2012,

2.**M.B.**, ish- administrator i rajonit nr. 4,

3.**D.K.**, me detyrë ish specialiste për kontrollin e projekteve, në Drejtorinë e Planifikimit, për 7 **ish-inspektorët** e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor Bashkia Vlorë respektivisht: **E.Q., K.P., D.C., I.H., J.D., A.L. dhe M.M.**

Shënim: Nga 9 ankesa të paraqitura në KLSH, grupi i auditimit për arsye të pamjaftueshme kohe ka trajtuar vetëm ankesën e z. S.F., kurse 8 letrat e tjera, disa janë me vendime gjyqësore 5 nga viti 2013 dhe 2 gjatë vitit 2014 dhe mendojmë, se mund të verifikohen me auditim tematik apo gjatë auditimit që do kryhet në ZVRPP, Vlorë. Gjithsesi, 2 letrat e vitit 2014, pasi të regjistrohen, mendojmë se duhet të trajtohen si ankesat e tjera duke u kthyer përgjigje nga punonjësi i ngarkuar me trajtimin e ankesave. Lista me ankesat paraqitet me poshtë:

Nr.	Emër mbiemër	Data	Problemi
1	Y.T.	04.04.2013	Keqëmenaxhim i bashkisë, korrupsion, Tek Futbolli
2	S.F.	4 letra	Leje shfrytëzimi, ZVRPP ,Vendim gjyqate

3	S.O.	14.04.2014	Leje ndërtimi (greva)
4	A.M.	05.11.2012	Detyrime nga urbanistika për supervizor, projektus
5	J.B.	03.12.2012	ZVRPP Vlorë
6	S.M.	05.07.2013	ZVRPP, leje ndërtimi (3 racat, kali Trojes)
7	R.S.	08.07.2013	Leje ndërtimi (3 racat)
8	I.T.	05.02.2014	Grabitje prone, Bashki, ZVRPP Vlorë
9	E.H.	03.03.2014	Leje ndërtimi

Nga Bashkia Vlorë, me shkresë nr. 2720/2, prot, datë 25.7.2014, protokolluar në KLSH me nr. 707/14 datë 25.7.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar pjesërisht dhe zbatuar po pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Niko Nako, Alush Zace, Piro Imeraj, Genc Koka, Rezart Golemi, Qemal Shehu, Margarit Stefa dhe Milo Pano më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT